



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Qeverisje dhe
Administrim Publik”**

ofruar nga

Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Klodiana Beshku (PhD)

PhD Noela Mahmutaj

Prill/2025

Tabela Përmbledhëse
Për Programin e studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe administrim publik”
Universiteti Privat, “Albanian University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 597, datë 28.05.2009.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR Nr. 6313/2 prot, date 18.07.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Nr. 411, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 22, datë 12.04.2019,
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023: 6 PAE /6 PAK V.a 2023-2024: 5 PAE/5 PAK

18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023: 21 studentë V.a 2023-2024: 12 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” filloi aktivitetin në vitin 2010 kur u hap për herë të parë me urdhër të MASH nr. 308, datë 08.06.2010, akredituar për herë të parë me urdhër të MASH nr. 499, më datë 18.10.2012 dhe riakredituar me vendim të bordit të akreditimit nr. 22, më datë 12.04.2019.

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, të Universitetit Privat “Albanian University”, Tiranë. Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe, në 1 vit akademik, me 60 ECTS. Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” synon të ofrojë një realizim të koncepteve në fushën e qeverisjes dhe administrimit publik dhe të analizojë rolin e sektorit publik në zhvillimin e vendit dhe lidhjet e tij me fusha të tjera të realitetit shoqëror. Misioni i këtij programi është të përgatisë studentë të cilët të aftësohen në hartimin e politikave publike brenda strukturave që lidhen direkt dhe indirekt me administratën publike qendrore dhe lokale. Qëllimi i këtij programi është të aftësojë studentin në njohjen e fenomeneve publike, si dhe rolin e administratorit publik.

Universiteti Privat, “Albanian University” ka përcaktuar drejtimet prioritare akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të IAL-së të përcaktuar në Statutin e tij.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të IAL-së. Programi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030.

Ky program realizon synimin e tij për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare përgjatë të gjithë dokumentacionit të hulumtuar me qëllim akreditimin e tij nga grupi i ngritur për hartimin e RVJ-së. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në fushën e Qeverisjes dhe Administrimit Publik dhe studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë, mund të punësohet si specialist në administratën e sektorit privat dhe publik. Njohuritë mbi sistemet politike, shkencat e administrimit dhe aftësimi profesional i ekspertëve të ardhshëm të administarës në fuksion të mbarëvajtjes së shtetit, janë nga objektivat e kryesorë të këtij programi.


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetëse të përcjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që realizoi në institucion në data 23 dhe 24 Tetor 2024, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacione të marra gjatë takimeve dhe intervistave që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me Dekanin e Fakultetit, drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, GVB, sekretarinë, zyrën e karrierës, punonjësen e bibliotekës, përfaqësues nga zyra Burimeve njerëzore etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret ligjore në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse si edhe VKM nr. 41 e vitit 2018 dhe udhëzimi nr.1 i vitit 2020.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Grupi i vlerësimit të jashtëm shqyrtoi rreth 90 evidenca të depozituara nga GVB në portalin e ASCAL si dhe rreth 20 të tjera evidenca shtesë të kërkuara gjatë vizitës në institucion prej GVB-së.

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të angazhuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Prof. Asoc. Dr. Klodiana Beshku (PhD) dhe PhD. Noela Mahmutaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Msc. Alma Arapi. Puna e GVJ-së është karakterizuar nga kriteret rigoroze profesionalizmi, paanshmërie dhe kredibiliteti të cilat sigurohen nga ekspertiza dhe eksperiencia e anëtarëve të GVJ-së.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.22, datë 12.04.2019 janë:

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të akreditimit numër 22, datë 12.04.2019 “Për akreditimin periodik për programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional në ‘Qeverisje e Adminstrim Publik’” Të Universitetit jo publik Albanian University janë si vijon:

1. Institucioni të rishikojë planin mësimor me qëllim rritjen e peshës së Praktikës mësimore në Programin e Studimit.
2. Institucioni të bëjë përpjekje për të mundur kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik si dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për të identifikuar dhe zhvilluar bashkëpunime me institucione partnere për të qenë pjesë e projekteve kombëtare e ndërkombëtare.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga institucioni

Për plotësimin e rekomandimeve, insitucioni në fjalë ka marrë këto masa:

1. Rishikimi i kurrikulës në lidhje me ndryshimin e peshës së Praktikës mësimore nuk ka qenë i mundur duke qenë se kjo peshë është në kuadrin e VKM-së numër 41, datë 24.01.2018 është 10%, pra brenda vlerës së lejuar 10-20%.
2. Në lidhje me rekomandimin që synon rritjen e nivelit të angazhimit të stafit të programit të studimit në konferenca e botime, Institucioni ka alokuar një fond prej 50.000 eurosh në vitin 2022, fond i cili është përdorur nga stafi i AU në mënyrë periodike për botime dhe konferenca (evidencë R.1.a). Përsa i përket shtimit të projekteve në kuadër të ndërkombëtarizimit të programit, AU ka bërë të mundur aderimin në projektin Horizon “Resilience” i cili është i vlefshëm deri në vitin 2022 (evidencë R.1.b) si edhe një sërë marrëveshesh në kuadrin e programit Erasmus (evidencë R.1.b).

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin, sqaron si vijon:

Lidhur me komentitn e institucionit për standardin:VI.5,kriteri 4; duke marrë në konsideratë evidencën e dërguar me shkresë nr Prot, 137/1 më 18 mars 2025 nga AU, GVJ e ka rishikuar dhe ka vendosur të pranojë komentin e bërë nga institucioni.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional, në “Qeverisje dhe Administrim Publik”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Privat “Albanian University”, si institucioni i cili ofron Programin Masteri Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” është kujdesur që ky program të jetë në linjë me interesat kombëtarë për diplomimin e individëve, qytetarëve dhe ekspertëve të përgatitur në qeverisje e administrim publik si edhe me një ndjenjë të lartë detyre dhe etike profesionale. Programi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030. Ky program realizon synimin e tij për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare përgjatë të gjithë dokumentacionit të hulumtuar me qëllim akreditimin e tij nga grupi i ngritur për hartimin e RVJ-së.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Masteri Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, të shprehura këto në Statutin e AU (evidenca 1.1.a.b), në Planin strategjik të Albanian University (evidenca 1.2 a, b) dhe në Planin Strategjik për Zhvillimin Institucional (evidenca 1.3 a, b). Ky program është në linjë me misionin e shprehur në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative (DSHJPA) (evidenca 1.4) si edhe me Strategjinë e këtij Departamenti (evidencë 1.5). <i>Evidenca 1.1.a Statuti AU</i> <i>Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023 i ri</i> <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar</i>



	<i>Evidenca 1.3.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022</i> <i>Evidenca 1.3.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative</i> <i>Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi i studimit (evidenca 2.1) është në përputhje me Planin Strategjik për Zhvillimin Institucional (evidenca 1.3 a, b), me planin e masave të marra në kuadër të strategjisë (Evidencë 1.6), me Statutin e Institucionit (evidenca 1.1 a, b) dhe Rregulloren e Institucionit (1.2 a, b). Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative i cili e implementon këtë program ka hartuar Strategjinë e tij (evidenca 1.5) si edhe planin e masave për realizimin e objektivave strategjike të këtij Institucioni (evidencë 1.6). <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik</i> <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditeluar</i> <i>Evidenca 1.3.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022</i> <i>Evidenca 1.3.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028</i> <i>Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative</i> <i>Evidenca 1.6 Plani i masave i marrë në kuadër të strategjisë</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit (evidencë 2.1) është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjeve globale të zhvillimit. Ky program është mbështetur në Strategjinë Institucionale (evidencë 1.3 a, b), në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 1.3.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022.</i> <i>Evidenca 1.3.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe</i>

	<i>misionin e institucionit, të shprehura këto në Statutin e AU, Planin strategjik të Albanian University, Planin Strategjik për Zhvillimin Institucional, Rregulloren e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative si edhe me Strategjinë e këtij Departamenti. Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti Privat “Albanian University”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka kapacitetin, burimet dhe përvojën e duhur për ofrimin e Masterit Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” si në burime njerëzore ashtu edhe në kapacitete infrastrukturore. Programi në fjalë ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative i cili ka në përvojë të gjerë e të hershme në shkencat administrative pasi edhe cikli Bachelor është i specializuar në këtë drejtim, ndërsa vetë institucioni (AU) ka një përvojë të gjatë në shkencat juridike dhe administrative. Kjo dëshmon se ky program ndodhet në vendin e duhur përse i përket përshtatshmërisë së tij me institucionin që e ofron si dhe me njësinë bazë.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe	Programi i studimit Master Profesional “Qeverisje e Administrim Publik” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Ky Fakultet përfshin fushën e përgjithshme/specifike studimore-shkencore që është ajo e shkencave juridike dhe politiko-administrative në të cilin lëvron ky program. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore

udhëzimeve kombëtare e evropiane.	përgjegjëse për programin e studimit dhe është në linjë me direktivat dhe udhëzim kombëtare dhe evropiane.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i Masterit profesional në fjalë ka për bazë fushën e shkencave politike dhe shkencave të administrimit, të dyja në përputhje me ato çka Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, njësia bazë e cila ofron programin, ofron dhe mbështet kërkimin shkencor. Ky program ka edhe element të shkencave juridike e ato ekonomike, të dyja fusha që ofrohen e mbështeten në kërkim shkencor prej Fakultetit të Shkencave Sociale të AU.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	NA.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti jo publik “Albanian University” ofron trajnime profesionale për stafin e brendshëm dhe studentët e regjistruar. Ofrimi i këtyre trajnimeve për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit mbetet një sfidë e mëtijshme për të gjithë sistemin universitar shqiptar.			
Konkluzione	<i>Universiteti jo publik “Albanian University”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka kapacitetin, burimet dhe përvojën e duhur për ofrimin e Masterit Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” si në burime njerëzore ashtu edhe në kapacitete infrastrukturore e në ofrimin e praktikës e të trajnimeve profesionale për stafin dhe studentët e këtij program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave duket qartë si në planin vertikal, mes rektorit/dekanit/përgjegjësit të departamentit ashtu edhe në atë horizontal mes përgjegjësit të departamentit/titullarëve të lëndëve. Koordinator i caktuar në vitin 2021 nuk është më staf i brendshëm në këtë institucion (Evidenca 2.3). Nuk kishte një Koordinator programi në nivel departamenti në periudhën e vizitës nga GJV në institucion. Analiza e punës në nivel njësie bazë realizohet në mënyrë periodike, siç na u kofirmua edhe përgjatë vizitës në insitucion, por siç edhe është e dukshme nga Raportet një vjeçare dhe 6 mujore. <i>Evidenca 2.3. Shkresa per caktimin e koordinatorit te programit te studimit</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti jo publik “Albanian University” zotëron marrëveshje të ndryshme me Institucione brenda dhe jashtë vendit të listuara në Planin Strategjik të DShJPA (evidenca 1.5, faqe 11,12). Ndër to nuk ka marrëveshjet me biznese e kompani të ndryshme të sektorit privat për realizimin e praktikës profesionale. Kjo praktikë është zhvilluar kryesisht në institucione të administratës qendrore e lokale. Rekomandohet një shtrirje e praktikave edhe në administratën e kompanive e bizneseve private, jo vetëm të atyre publike. Institucionet me të cilët IAL/ja ka marrëveshje janë listuar gjithashtu në raportin analitik vjetor (evidenca 1.9). <i>Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i>
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të	Universiteti Privat “Albanian University” disponon marrëveshje me IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit, me Institute e Qendra të Kërkimit shkencor, por jo bashkëpunime zyrtare me punëdhënësit të sektorit privat për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, duke qenë se një program masteri profesional e ka shumë të rëndësishëm këtë komponent.

fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Departamenti përcakton një udhëheqës për praktikat mësimore i cili koordinon punën mes insitucioneve që ofrojnë praktikat dhe këtij program masteri. Siç shihet nga evidence E.2, koordinatori për praktikat ndryshon herë pas here në bazë të nevojave dhe ngarkesës mësimore të stafit të programit. Sugjerohet një koordinator i përhershëm për praktikat për këtë program. <i>Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>E.2. Praktika e ndjekjes së studentëve gjatë praktikës.</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti ka hartuar një raport analitik vjetor (evidenca 1.9) në të cilin janë të listuar institucionet me të cilët IAL/ja ka marrëveshje dhe një raport semestral ku flitet për ecurinë e praktikave profesionale (evidencë 1.10). <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i>			
Konkluzione	Departamenti ka hartuar një raport analitik vjetor në të cilin janë të listuar institucionet me të cilët IAL/ja ka marrëveshje dhe një raport semestral ku flitet për ecurinë e praktikave profesionale. Ndër to nuk ka marrëveshjet me biznese e kompani të ndryshme të sektorit privat për realizimin e praktikës profesionale. Rekomandohet një shtrirje e praktikave edhe në administratën e kompanive e bizneseve private, jo vetëm të atyre publike. Gjithashtu, sugjerohet një koordinator i përhershëm për praktikat për këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” (evidencë 2.1) i ofron studentëve një specializim të mëtijshëm në Shkenca Politike dhe shkenca të administrimit publik. Në bazë të këtij programi, studentët përftojnë dijet e nevojshme për të vazhduar rrugëtimin në kërkimin shkencor ose për tu përfshirë në tregun e punës si ekspertë të administratës publike ose private. Ky program është i organizuar në kredite dhe module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas këtij sistemi dhe sipas VKM-së 41 të vitit 2018, ky program duhet të ketë një ndarje të tillë të sistemit të krediteve: Masteri profesional: Lëndë bazë (A): 5%-10% Lëndë karakterizuese (B): 30%-40% Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C): 20%-30% Lëndë plotësuese (D): 10% Detyrime përmbyllëse (E): 10%-20% Duke u nisur nga kjo ndarje, konstatojmë se Programi i Studimit Master Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” (evidencë 2.1) dhe ndarja sipas kategorive të lëndëve sipas Rregullores së Programit (evidenca 1.7, tabela 2) i përmbush këto detyrime në përputhje me VKM-në 41 e vitit 2018. <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë	Ky program studimi synon formimin e shprehive të veçanta në shkenca politike, administrim publik e qeverisje të mirë, transparente e të hapur.

studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ai jep njohuri të përparuara në një këto fusha, duke lehtësuar punësimin në ambiente të lidhura me këto fusha si administrata publike e ajo private. Mësimdhënia, në linjë me parimin kryesor të shkencave politike, mundëson të kuptuarin dhe mendimin kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së administrimit publik. Ky program zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në qeverisje dhe administrim publik, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në tregun e punës apo në zbatimin e politikave publike.
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në kurrikulën/planin mësimor të Masterit Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” është përcaktuar qartë ngarkesa në kredite e praktikës profesionale (6 kredite) dhe detyrimeve përmbyllëse (6 kredite), secila llogaritur në përqindje shkon në kuotën 10% (evidencë 2.1). Kjo përqindje është në linjë me VKM-në 41/2018. <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	NA

krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti Privat “Albanian University” nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nuk ka një program tjetër Master në të njëjtën fushë studimi në IAL-në që ofron këtë program studimi. Nuk ka në asnjë IAL tjetër program me këtë emërtesë, pra në masën 70% nuk ka ngjashmëri.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit ende nuk ka kodin përkatës sipas udhëzimit të MASR nr 31, dt. 15.11.2022.

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Masterit Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera			
Konkluzione	<i>Ky program është i organizuar saktësisht në kredite dhe module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas VKM-së 41 të vitit 2018.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të bazuara në strategjitë kombëtare e insitucionale dhe në përditësim të vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Struktura dhe stafi akademik i programit është brenda kriterëve të përcaktuara nga Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor 2015, Udhëzimi nr.1 i datës 14.01.2020 dhe VKM-ja e datës 24.01.2018, siç verifikohet lehtësisht nga evidenca 2.1 e programit mësimor dhe evidence 4.1 e ngarkesës mësimore të stafit akademik. Fakulteti i Shkencave Shoqërore për dy vite akademike ka në përbërjen e tij:



	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
		1	1	1	1
		3	4	2	6
		7	12	7	7
		3	7	3	4
		Total	14	24	13
	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
		2	2	2	2
		6	12	8	14
		18	29	16	14
		6	17	7	10
		Total	32	60	33
	<i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i>				
	Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore,				
	Në kuadër të marrëveshjeve që ka institucioni me institucionet e tjera (Raporti vjetor 2022-2023, evidence 1.9), institucioni pritës ka detyrim të përcaktojë një koordinator për praktikantët i cili mban kontaktet me Departamentin dhe raporton për aktivitetin e studentëve praktikantë. Njësia bazë ka të angazhuar sipas rastit një pedagog përgjegjës për praktikantët mësimore e cila merr në mbikëqyrje grupin e studentëve (evidencë 4.1). Gjatë vizitës në institucion na u bë me dije mënyra e organizimit të praktikave, roli i institucioneve dhe i koordinators të praktikave si urë lidhëse mes studentëve dhe institucionit, raporti i vlerësimit si edhe mënyra e konvertimit të këtij raporti në notë nga koordinatori/ja e praktikave. <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i>				



laboratorike e klinike, etj.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas evidencës 2.3, ky program ka të përcaktuar një Koordinator i cili merret me ecurinë e programit, por ky vendim i përket vitit 2021. Pedagogia në fjalë nuk është më pjesë e stafit akademik të këtij programi. Përgjatë vizitës në institucion nuk na u prezantua një koordinator tjetër i këtij programi. <i>Evidenca 2.3. Shkresa per caktimin e koordinatorit te programit te studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Programi në fjalë ka një raport shumë të mirë PAK/PAE dhe pedagogë shumë të përgatitur në të dyja kategoritë që japin mësim aty. Programi nuk ka një Koordinator që prej vitit 2022, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, një figurë mungesa e cila është shumë e rëndësishme për këtë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, informacion i cili ndodhet i depozituar në platformën e-ASCAL dhe na u vu edhe në dispozicion përgjatë vizitës në institucion.



dhe përmbajtjen e programit të studimit.	
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i këtij programi dhe syllabuset e tij (evidenca 2.1 2. 2) përmbajnë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit të PAE dhe të PAK (evidenca 4.1) si edhe evidencat shitesë të dërguara pas vizitës së GVB-së në institucion (Evidencat E.8). Ngarkesa mësimore, përfshirë orët në auditor/jashtë auditorit janë konform rregulloreve dhe direktivave në fuqi, sipas këtij raporti: Lëndë bazë (A): 6 kredite = 10% Lëndë karakterizuese (B): 24 kredite = 40% Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C): 18 kredite = 30% Lëndë plotësuese (D): 6 kredite = 10% Detyrime plotësuese (E): 6 kredite = 10% Ky program është i organizuar në kredite dhe module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas këtij sistemi dhe sipas VKM-së 41 të vitit 2018, ky program duhet të ketë një ndarje të tillë të sistemit të krediteve: Masteri profesional: Lëndë bazë (A): 5%-10% Lëndë karakterizuese (B): 30%-40% Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C): 20%-30% Lëndë plotësuese (D): 10% Detyrime përmblylëse (E): 10%-20% Duke u nisur nga kjo ndarje, konstatojmë se Programi i Studimit Master Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” (evidenca 2.1) dhe ndarja sipas kategorive të lëndëve sipas Rregullores së Programit (evidenca 1.7, tabela 2) i përmbush këto detyrime në përputhje me VKM-në 41 e vitit 2018. <i>Evidenca 5: Tabelat përmbledhese aneks RVB.pdf</i> <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i> <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2020-2021 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2021-2022 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i>



	<i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2022-2023 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2023-2024 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	“Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve” e Albanian University (evidenca 2.4) përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky proces është lehtësisht i realizueshëm nëpërmjet një kërkesë të thjeshtë pranë sekretarisë mesimore, nën respektimin e kohërave të pritjes të parashikuara nga kjo rregullore. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Regjistrimit dhe Trasferimeve</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Plani mësimor i këtij programi dhe syllabuset e tij (evidenca 2.1 dhe 2.2) përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Megjithatë procedura e rishikimit të syllabus-eve e parashikon qartë mënyrën se si mund të rishikohen ato (evidenca 2.5), vihet re një mungesë përditësimi të programeve të lëndëve (syllabuseve) me literaturën e këtyre viteve të fundit. <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i> <i>Evidenca 2.5. Procedura e rishikimit te syllabuseve.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në fillim të vitit akademik përgjegjësi i Departamentit duhet të angazhohet në verifikimin e përditësimit të syllabuseve të këtij programi sipas Procedurës së Rishikimit të Syllabus-eve (evidencë 2.5) dhe në ndryshimin e 20% të kurrikulës, sipas legjislacionit në fuqi sipas Procedurës së rishikimit të Kurrikulave (evidencë 2.6). Nuk ka pasur rishikim të programit në këto vite pas akreditimit të fundit të programit në fjalë në vitin 2019, por edhe rishikimi i syllabus-eve nuk është kryer sipas procedurës prej përgjegjësit të njësisë bazë. <i>Evidenca 2.5. Procedura e rishikimit te syllabuseve.</i>

	<i>Evidenca 2.6. Procedura e rishikimit te kurrikulave.</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative ofron të gjithë instrumentet e nevojshëm për organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe transferimet në lidhje me programin e studimit. Vihet re një mungesë përditësimi të programeve të lëndëve (syllabuseve) me literaturën e këtyre viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” është i konceptuar nën një linjë thellimi të njohurive dhe aftësive të përfuara përgjatë një sistemi bachelor në shkenca sociale dhe të ngjashme (shkenca të administrimit në rastin konkret). Ai synon punësimin e studentëve në administratë publike ose private pas përfundimit të studimeve, synon të krijojë ekspertë në hartimin dhe analizimin e politikave si edhe në komunikimin politik dhe institucional.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët dhe modulet janë të shpërndara në semestra për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme në profesionalizimin e studentëve të këtij masteri në mënyrë graduale brenda 1 viti. Kjo ndarje mundëson arritjen e objektivave që i ka vendosur vetes ky program në lidhje me ekspertizën që ai synon të arrijë tek të diplomuarit e tij.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në	Struktura e programit është në përputhje me profilin e një programi studimi Master Profesional dhe si i tillë ai duhet të ketë një komponent të fortë të formimit të thelluar profesional.

përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në këtë kuadër, (bazuar në tabelën n.13, evidence 5) veprimtaritë formuese në këtë program ndahen si më poshtë: <i>Leksione 300 orë</i> <i>Seminare 137 orë</i> <i>Detyra kursi 7 orë</i> <i>Praktikë profesionale 120</i> <i>Përgatitje për provimin e Fromimit/Temën e diplomës 12 orë</i> Sipas kësaj ndarjeje, vihet re se komponenti i formimit të thelluar profesional është realizuar së bashku me komponentë të tjerë. Programi i Masterit profesional “Qeverisje dhe Adminsitrim Publik” gjendet edhe në linkun e web-it të AU: https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-shoqerore-2/ <i>Evidenca 5: Tabelat permbledhese aneks RVB.pdf</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundëson arritjen e objektivave formuese për këtë program. Kjo ndarje lehtëson transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në përfundim të studimeve, në linjë me rregulloret dhe legjislacionin përkatës.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative dhe përgjegjësi i kësaj njësie bazë duhet të angazhohen në përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut dhe të transformimeve të shoqërisë prej teknologjisë. Mundësitë që fasilitojnë këtë proces janë të shumta në AU duke duke filluar me përditësimin periodik të literaturës në bibliotekën e Albanian University sipas Rregullores së Bibliotekës (Evidenca E.3) nëpërmjet porosisë së herëpashershme të librave vërtetuar gjatë vizitës dhe prej Raportit analitik për literaturën shtesë në Bibliotekë (Evidenca E5) si edhe nëpërmjet mundësisë për të shkarkuar materiale online nëpërmjet EBCSO-s (Evidenca E 4.2).

	<i>E.3. Rregullore e Biblotekes.</i> <i>E.4.2 Marreveshja AU&AC per EBSCO.</i> <i>E.5. Raporte analitike për literaturën shtesë në bibliotekë.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Masteri Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” synon të formojë individë të përgatitur për të punuar në administratë, shoqëri civile dhe insitucione politikëbërëse e politikëhartuese. Përmbajtja e këtij programi e garanton këtë formim. Programi përmban lëndë ndërdisiplinore në fushat e studimeve europiane, komunikimit publik, menaxhimit të burimeve njerëzore etj., një element i cili pasuron formimin e studentëve në drejtimin e qeverisjes e politikave publike.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Formimi praktik në kuadrin e këtij programi dhe ndjekja e shoqërimit i studentit përgjatë këtij procesi (Rregullorja e Programit: evidenca 1.7, evidenca E.5: Praktika e ndjekjes së studentëve gjatë praktikës) bën të mundur integrimin më të shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës. Punësimi i studentëve lehtësohet edhe nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare (evidenca 1.8) ku panairët, simpoziumet apo tryezat e rrumbullakëta kanë paur si qëllim afrimin e studentëve me përfaqësues të institucioneve publike e private dhe ekspertë të fushës. Një shembull i mirë në këtë drejtim është Panairi <i>Work and Study</i> (Evidenca 5.4). <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare.</i> <i>E.5. Raporte analitike për literaturën shtesë në bibliotekë.</i> <i>Evidenca 5.4 Panairi Work & Study.pdf</i>
Konkluzione	<i>Lëndët dhe modulet e këtij programi janë të shpërndara në semestra për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit dhe profesionalizimin e studentëve të këtij masteri në mënyrë graduale brenda një viti. Formimi praktik në kuadrin e këtij programi dhe ndjekja e shoqërimit i studentit përgjatë këtij procesi bën të mundur integrimin më të shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës. Nuk ka pasur një përditësim të vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut dhe të transformimeve të shoqërisë prej teknologjisë nga përgjegjësi i njësisë bazë.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka kryer në mënyrë periodike studimin e tregut (Evidenca 2.8) me qëllim adaptimin e këtij programi me kërkesat e tregut dhe përmirësimin e përmbajtjes së këtij programi duke u përpjekur të marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe të aktorëve të tjerë. <i>Evidenca 2.8. Analizë e tregut të punës.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti Privat “Albanian University” është një institucion shumë i kujdesshëm ndaj kërkesave të studentëve dhe mbarëvajtjen e tyre edhe pas përfundimit të këtij program, nëpërmjet koordinatorit për studentët dhe takimeve periodike me ta në kuadrin e Këshillit Studentor dhe Senatit Akademik duke krijuar rrjetin e studentëve alumni (evidenca 2.9). Programi i përshtatet studentëve përsa i përket fleksibilitetit në orare dhe kërkesa të tjera specifike që ata mund të kenë. Kjo na u konfirmua edhe përgjatë vizitës në institucion ku studentët u shprehën se ndjekja e programit ishte lehtësuar prej këtij fleksibiliteti të zbatuar nga AU. <i>Evidenca 2.9. Model pyetesori ALUMNI.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative mban kontakte me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.

përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Sugjerimet e tyre mund të ishin reflektuar në rishikimin e kurrikulës, por nuk ka pasur ndonjë rishikim të tillë në këto vitet e fundit. Në grupin e ekspertëve janë të angazhuar edhe ekspertë të jashtëm për përmirësimin e kurrikulave (evidenca 2.10) të cilët janë angazhuar në këtë process. Ata nuk e kanë parë të arsyeshme ndryshimin e programit (kurrikulës) në këtë fazë, por konsolidimin e tij. <i>Evidenca 2.10. Shkresa per ngritjen e komisionit per rishikimin te programit studimit.</i>			
Konkluzione	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative mban kontakte me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, por sugjerimet e tyre nuk janë reflektuar në rishikimin e kurrikulës në këto vitet e fundit. Programi i përshtatet studentëve përsa i përket fleksibilitetit ne orare dhe kërkesa të tjera specifike që ata mund të kenë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit janë shprehur qartë në Rregulloren e këtij Programi studimi (evidenca 1.7, kreu II, neni 4). Ato mund të përmbledhen në katër shtylla kryesore: 1. Pajisja e të diplomuarve me njohuri bazë mbi shkencat e administrimit; 2. Njohja e studentëve me koncepte bashkëkohore; 3. Thellim analiza të politikave dhe ekspertizë; 4. Pajisja e të diplomuarve me aftësi teorike, jo vetëm praktike. <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative respekton lirinë akademike të personelit akademik (evidencë 1.4). Kjo u evidentua edhe përgjatë vizitës së grupit për hartimin e RVJ-së në Albanian University ku pedagogët u shprehën të qetë dhe të lirë në punën e tyre.

mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Ata mbështeten vazhdimisht në veprimtarinë e tyre të përditshme por edhe atë shkencore dhe akademike nëpërmjet një fondi të posaçëm (Evidence R.1.a) të vënë në dispozicion nga Universiteti Privat “Albanian University”.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nësia bazë e këtij programi nxit dhe motivon studentët të angazhohen në Konferencën Studentore si edhe të botojnë në Revistën Optime (kopje të kësaj reviste na u vunë në dispozicion përgjatë vizitës në Institucion). Një sërë aktiviteteve si workshop-e, leksione të hapura, trajnime janë konceptuar dhe vënë në zbatim për studentët e AU dhe të këtij programi (evidence 2.11). I kushtohet vëmendje mobilitetit të studentëve (evidence 2.12) si dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare ku studentët aktivizohen në vetë të parë (Evidenca 1.8) dhe ndërveprojnë me ekspertë të fushave dhe përfaqësues të tregut të punës (Evidenca 1.8). <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative</i> <i>Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione të hapura, workshope, tryeza të rrumbullakta).</i> <i>Evidenca 2.12. Aplikimi në projekte Erasmus +, vIRTU eu etj.</i> <i>Evidenca R.1.a Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë.</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni, pra Albanian University. Pedagogët mbështeten në aktivitetin e tyre prej një Fondi të posaçëm për botimet dhe kërkimin shkencor (Evidence R.1.a). Evidenca R.1.a Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë.
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative respekton lirinë akademike të personelit akademik. Ai mbështetet vazhdimisht në veprimtarinë e tyre të përditshme por edhe atë shkencore dhe akademike nëpërmjet një fondi të posaçëm të vënë në dispozicion nga Albanian University.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative siguron bashkëpunimin me IAL të tjera dhe Institute apo Qendra Kërkimore Shkencore (evidence 4.1) për realizimin e objektivave të të gjithë programeve të studimit në kërkim shkencor, por duke qenë se ky program nuk e ka kërkimin shkencor qëllimin parësor të tij, më shumë rëndësi i jepet aspekteve më praktike të programit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka aplikuar në shumë projekte me qëllimin për të zhvilluar projekte të karakterit kërkimor shkencor (evidencat 2.12) dhe në kuadër të programit Erasmus+ janë kryer shkëmbime të stafit dhe të studentëve me institucione ndërkombëtare (evidence 2.13). <i>Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, vIRTU eu etj 2.</i> <i>Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, VirtU EU etj.</i> <i>Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus, Virt EU + etj 3.</i> <i>Evidenca 2.13. Mobiliteti i studenteve.</i> <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka zhvilluar Konferenca studentore si edhe leksione të hapura e seminare në funksion të tyre (Evidenca 2.11). Këto aktivitete kanë ndihmuar jo vetëm studentët, por edhe personelin që të shprehet në fushën përkatëse të interesit dhe të dijes që disponon. <i>Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione te hapura, workshope, tryeza te rrumbullakta).</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Kurrikula e këtij programi, shërbimet ndaj studentëve, përkushtimi ndaj tyre, vendosja e studentëve në kontakt me aktivitete ekstra-kurrikulare (Evidenca 2.11 dhe Evidenca 1.8) si dhe përpjekja për ti përgatitur këta studentë, ndikojnë në

	formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e kombëtar e ndërkombëtar të punës. <i>Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione te hapura, workshope, tryeza te rrumbullakta).</i> <i>Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare.</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	NA			
Konkluzione	<i>Ky program mund të konsiderohet i suksesshëm në formimin e profesionistëve për tregun e kombëtar e ndërkombëtar nëpërmjet kurrikulës së tij, shërbimeve ndaj studentëve, përkushtimin ndaj tyre si edhe me angazhimin e studentëve në aktivitete ekstra-kurrikulare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Transmetimi i dijeve, format e mësimdhënies e mësimnxënies janë të parashikuara në syllabus-et e lëndëve (evidencë 2.2) si edhe në Rregulloren mësimore të Programit të studimit (evidence 1.7). Personeli akademik ushtron si format e mësimdhënies klasike, ashtu edhe ato inovatore, nëpërmjet leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, debateve, simulimeve si edhe formave të reja alternative nëpërmjet mjeteve vizuale bashkëkohore. Përdorimi i këtyre formave na u konfirmua edhe prej vetë studentëve përgjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca 2.2. Syllabusët e lendeve.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik është shumë i ndjeshëm ndaj nevojave të studentëve dhe i përkushtohet mësimdhënies me forma e mënyra tradicionale dhe alternative si debate, simulime, etj. Përdorimi i këtyre formave alternative na u konfirmua edhe prej vetë studentëve përgjatë vizitës në institucion.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti Privat "Albanian University" e mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet shkëmbimeve të personelit akademik në projekte të ndryshme, trajnimeve, nxitjen në kërkimin shkencor, pjesëmarrjes në konferenca etj., si edhe në aplikime dhe mobilitet në kuadrin e programit Erasmus (evidence 2.12).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në këtë program është i kualifikuar dhe kompetent për të realizuar lëndët e këtij programi, si në rrafshin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Disa

është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	pedagogë të këtij programi vijnë me një eksperiencë të konsidrueshme në administratën publike e private (evidenca 3.1). Kjo bën që studentit ti përcillet edhe eksperiencia praktike, krahas teorisë. Disa pedagogë të tjerë që japin mësim në këtë program zotërojnë përgatitje të larta teorike, në linjë me nevojat e këtij programi. Studenti është në qendër të këtij programi. Synohet nxitja tek studentët të mendimit krijues, atij kritik si dhe autonomia e përgjegjshmëria e tyre. AU siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes studentëve dhe pedagogëve. Gjatë vizitës në institucion u vu re një marrëdhënie shumë e mirë mes studentëve dhe pedagogëve të këtij programi dhe një mirënjohje e lartë nga ana e studentëve për mësimdhënësit e tyre dhe mbështetjes të pakufijshme që ata iu kishin ofruar. <i>Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, vIRTU eu etj 2.</i> <i>Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, Virtu EU etj.</i> <i>Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus, Virt EU + etj 3.</i> <i>Evidenca 3.1 Curriculum Vitae te personelit akademik te angazhuar ne mesimdhenie.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	DSHJPA rreket të përmirësojë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre të cilat merren nëpërmjet pyetësorëve nga NjSBC dhe fokus-grupeve (Evidence 3.2 dhe 3.3). Gjithashtu <i>feedback</i>-u i studentëve merret edhe nëpërmjet përfaqësuesve në Këshillin studentor, kryetari i të cilit është edhe pjesë e senatit. <i>Evidenca 3.2.a Rezultatet e pyetesoreve te studenteve.</i> <i>Evidenca 3.2. b Rezultatet e Fokus grupeve.</i> <i>Evidenca 3.3 Shembull pyetesori ne platformen Teams.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë	NJSBSC është shumë aktive në Albanian University (evidence 1.1 a, b). Kjo njësi në punën e saj mbështetet nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave (evidence 1.1 a, b) dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (evidence 3.5).

dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në nivel njësie bazë, Përgjegjësi i Departamentit dhe Koordinatori i programit sigurohen që të sigurohet cilësi në mësimdhënie nëpërmjet përfshirjes së metodave të reja të mësimdhënies. Stafi mësimdhënës mbështetet nga Institucioni në trajnime e specializime por edhe për publikime shkencore dhe kërkim shkencor në vija më të përgjithshme nga Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë i vënë në dispozicion nga AU për pedagogët e këtij institucioni (Evidenca R.1.a). <i>Evidenca 3.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.</i> <i>Evidenca 1.1.a Statuti AU.</i> <i>Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023 i ri.</i> <i>R.1.a Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë.</i>			
Konkluzione	<i>DSHJPA rreket të përmirësojë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces, duke i dhënë përparësi NjSBSC-së, duke mbështetur stafin mësimdhënës mbështetet me trajnime e specializime por edhe për publikime shkencore dhe kërkim shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit bazohen në Rregulloren e programit të studimit (evidence 1.7), në Rregulloren e Institucionit (evidence 1.2 a dhe b) dhe në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative (evidence 1.4). Ato janë të shprehura qartë në syllabuset e lëndëve dhe iu bëhen të ditura studentëve nëpërmjet këtyre të fundit (evidence 2.2), sipas këtij modeli të njehsuar: <table><tr><td>Format e kontrollit të njohurive</td><td>Pjesa në përqindje ndaj totalit</td></tr></table>	Format e kontrollit të njohurive	Pjesa në përqindje ndaj totalit
Format e kontrollit të njohurive	Pjesa në përqindje ndaj totalit		

	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive		10%	
	Plotësimi i detyrimeve		10%	
	Testimet gjatë vitit		20%	
	Provimi përfundimtar		60%	
	Në total		100%	
	<i>Evidenca 5: Tabelat permbledhese aneks RVB</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Syllabuset e lëndëve, të cilët përmbajnë metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, iu bëhen të ditur studentëve në çdo fillim lënde. Syllabuset (evidencë 2.2) dhe Kodi i Etikës (evidence 3.6) iu bëhen të qartë studentëve përgjatë javës së parë të leksioneve për çdo semestër. Informacioni mbi çdo lëndë dhe mbi programin mund të aksesohet përgjatë gjithë vitit në website-n e institucionit. <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i> <i>Evidenca 3.6 Kodi i Etikes.</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, sipas mënyrës së përshkruar nëpër syllabus-et përkatëse të lëndëve (evidenca 2.2). Informacioni mbi çdo lëndë dhe mbi programin mund të aksesohet përgjatë gjithë vitit në website-n e institucionit. <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i>			
Konkluzione	Kriteret dhe mënyrat e testimit janë të shprehura qartë në syllabuset e lëndëve dhe iu bëhen të ditura studentëve nëpërmjet këtyre të fundit. Informacioni mbi çdo lëndë dhe mbi programin mund të aksesohet përgjatë gjithë vitit në websiti-n e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, sipas mënyrës së përshkruar nëpër syllabus-et përkatëse të lëndëve (evidencë 2.2). <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni aplikon sistemin elektronik PITAGORA për hedhjen e rezultateve dhe kalkulimin e tyre (3.7) dhe kryen të gjitha procedurat sipas rregullave të departamentit (evidenca 1.2 a, b). Sistemet elektronike të testimit nuk janë të aplikueshme për provime me shtjellime të çështjeve dhe jo me alternativa, ndaj korrigjimi manual përdoret më shpesh në shkencat sociale. <i>Evidenca 3.7 Manual i përdorimit të Pitagorës.</i> <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter.</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin Master Profesional “Qeverisje dhe Administrim Publik” kryhet duke u bazuar në syllabus-et e lëndëve përkatëse, si një shumatore e pikëve të frekuentimit, provimeve të ndërmjetme dhe atij final e duke i konvertuar më pas pikët në notë (Tabela e vlerësimit, evidence 1.7 dhe 3.8).
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi	Pedagogët e lëndëve, pas vlerësimit të provimeve, realizojnë ballafaqimin me provimin, ku studenti merr <i>feed-back-un</i> e duhur. Më pas notat hidhen në procesverbalin e tyre, brenda afateve të caktuara. <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>

procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Procedura e zhvillimit të provimeve parashikon monitorimin e sallës si edhe mospërdorimin e celularëve. Kopja dhe palgjatura janë të dënueshme sipas rregulloreve dhe kodit etik dhe studentët informohen për këto penalizime që në fillim të vitit akademik (evidenca 3.9). <i>Evidenca 3.9 Manuali per punimin e temave te diplomes.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen brenda 7 ditëve, sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të ankimojë vlerësimin e provimit. Në këto raste, ngrihet një Komision <i>ad-hoc</i> për rishikimin e vlerësimit dhe është trajtuar çështja sipas rastit përkatës (evidencë 1.7). Studentët, gjatë vizitës në institucion, u shprehën se kjo procedurë ka funksionuar mirë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit dhe se zëri i tyre është dëgjuar në rastet kur kanë pasur ankime në lidhje me provimin e kryer. <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Siç u përmend edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi, ka pasur raste ankimesh dhe ato janë trajtuar në përputhje me rregulloren e programit. Menjëherë është ngritur një Komision <i>ad-hoc</i> për rishikimin e vlerësimit, sapo studenti ka bërë kërkesë për rishikim të vlerësimit (evidencë 1.7). <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Konkluzione	<i>Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin Master "Qeverisje dhe Administrim Publik" kryhet duke u bazuar në parashikimin e në syllabus-e dhe në rregulloret përkatëse, duke i dhënë rëndësinë e</i>

	<i>duhur procesit të ballafaqimit të studentit me vlerësimin dhe procedurës së ankimimit të këtij vlerësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit, nëpërmjet dimensionit teorik dhe praktik të tij, garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve që ndjekin këtë Master. Në këtë program i vendoset një rëndësi e veçantë njohjes së studentëve me administratën publike, sistemeve politike, politikave publike, por njëkohësisht edhe aftësimin të tyre në rrafshin praktik nëpërmjet simulimeve, detyrave të kursit, debateve dhe praktikës nëpër institucione (evidencë 2.1 dhe evidencë 2.2). <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit është i konceptuar në mënyrë tradicionale, por zotëron edhe hapësirën e duhur për t'ju përshtatur kohës dhe zhvillimeve teknologjike. Këtë mundësi e ofron jo vetëm kurrikula e konceptuar për këto zhvillime, por edhe facilitetet që vijnë prej laboratorëve dhe instrumentave të tjerë teknologjikë që ofron Universiteti jo publik "Albanian University" në funksion të studentëve të regjistruar. Gjithashtu programi i këtij Masteri profesional ofron lëndë që ndikojnë në aftësitë komunikuese të studentëve të tij si Komunikim publik dhe Marketing institucional si edhe Teoria dhe Praktika e Liderimit (evidencë 2.1 dhe 2.2). <i>Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i>

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllabuset e çdo lënde janë të hartuara me kujdes nga titullarët e lëndëve. Aty janë paraqitur me saktësi kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të asaj lënde dhe janë specifikuar çështjet më të rëndësishme si edhe detyrimet përmbyllëse të studentit (evidencë 2.2). <i>Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia zhvillohet duke pasur parasysh se çfarë do tu duhet studentëve në praktikë, duke qenë ky një program Master profesional. Personeli akademik zhvillon diskutime dhe punë në grup, edhe sipas dëshmive të studentëve përgjatë takimit me ta të GVJ-së. Studentët, siç u tregua edhe përgjatë këtij takimi, ishin të lirshëm, pa komplekse, të kënaqur nga puna e pedagogëve, nga nxitja e tyre për studim e thellim të mëtejshëm, si edhe për mendim kritik dhe diskutime. Të gjithë këta elementë janë tregues të një klime pozitive në institucion. Mobiliteti i studentëve, ndonëse i nxitur prej pedagogëve të tyre, nuk ka qenë shpesh i aktivizuar në këtë program, kjo edhe prej karakterit profesional të këtij programi si edhe prej kohëzgjatjes së kufizuar prej një viti që ky program mbart.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	Personeli akademik si dhe ai me kontratë realizon leksione të hapura dhe seminare, aktivitete të larmishme në IAL sipas evidencës 1.8 e cila përshkruan aktivitetet ekstrakurrikulare të zhvilluara në vitet e fundit. Në këto aktivitete kanë qënë të ftuar ekspertë kombëtarë si B. Çejku, E. Karamuço, A.Krasniqi etj., si edhe janë trajtuar tema

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	me interes për studentët e këtij program, nga vendi dhe bota dhe të lidhura me përmirësimin e qeverisjes dhe të politikave publike. <i>Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare.</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Universiteti Privat “Albanian University” nxit dhe mbështet studentët përgjatë të gjithë rrugëtimit të tyre, në ide inovative dhe projekte kërkimore. Konferenca studentore është një shembull i mirë në këtë drejtim, gjithashtu edhe aktivitetet e tjera sipas listës së aktiviteteve ekstrakurrikulare (evidencë 1.8), panairi i punës Work&Study (evidencë 5.4) dhe leksioneve të hapura mbi nxitjen e studentëve për punësim (evidencë 5.8 dhe 5.9). <i>Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare</i> <i>Evidenca 5.4 Panairi Work & Study</i> <i>Evidenca 5.8 Leksion i hapur "Si të punësohesh".</i> <i>Evidenca 5.9 Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim.</i>			
Konkluzione	Mësimdhënia zhvillohet duke pasur parasysh se çfarë do tu duhet studentëve në praktikë, duke u mbështetur në një personel akademik të përgatitur i cili nxit diskutime dhe punën në grup. Universiteti Privat “Albanian University” nxit dhe mbështet studentët përgjatë të gjithë rrugëtimit të tyre, në ide inovative dhe projekteve kërkimore. Personeli akademik si dhe ai me kontratë realizon leksione të hapura dhe seminare, aktivitete të larmishme në IAL.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Studimet e Masterit profesional “Qeverisje dhe Administrim publik” përmbyllen me provim formimi ose temë diplome, sipas Rregullores së AU-së (evidencë 1.2 b), Rregullores së Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative

realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	(evidencë 1.4), Rregullores së Programit të Studimit (evidencë 1.7) dhe Rregullores së Diplomimit (evidencë 3.8). Procedura e provimit të formimit ose diplomimi janë të përshkruara qartë në këto dy të fundit. <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter.</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituar.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Çdo student që kërkon të realizojë një temë diplome, i vendoset në dispozicion një udhëheqës/e diplome i/e cili/a e orienton me temën dhe literaturën, si edhe një Manual mbi hartimin e temave të diplomave (Evidencë 3.8). Gjatë vizitës në institucion, studentët u shprehën shumë të kënaqur në lidhje me të gjithë procedurën e hartimit të temave të diplomave si edhe atë të diplomimit. Ata folën me pasion për atë periudhë të rrugëtimit të tyre si edhe për temat e diplomave, hulumtimin e kryer dhe mbështetjen e pakursyer të pedagogëve të tyre, sidomos të pedagoges D. Pano. <i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final miratohet nga Dekani pas propozimit prej përgjegjësit të Departamentit sipas shkresës për ngritjen e këtij Komisioni (Evidencë 3.10). Më pas, procedura e vlerësimit konsiston në vlerësimin e disa aspekteve kryesore të temës së diplomës si cilësia e kerkimit shkencor, struktura dhe origjinaliteti (evidencë 3.11). <i>Evidenca 3.10 Shkresa për ngritjen e komisionit të diplomimit.</i> <i>Evidenca 3.11. Shembull procedure diplomimi.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston	Ata studentë të cilët zgjedhin që të kryejnë një punim diplome udhëhiqen nga një pedagog/e i/e departamentit. Udhëheqësi/ja e mbështet studentin/en përgjatë këtij rrugëtimi me literaturë dhe të gjithë orientimin e nevojshëm dhe më pas e miraton punimin për dorëzim. Në përdorim të studentëve është vendosur një manual “Si të shkruajmë një temë diplome”. Procedura e dorëzimit

studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	të temës së diplomës është e parashikuar në Rregulloren e programit dhe të Departamentit (evidence 3.8) dhe në atë të Sekretarisë mësimore (evidence 3.12). Përgjatë takimit me student në IAL, studentët u shprehën shumë të kënaqur me përkushtimin e pedagogëve të tyre si në udhëheqjen e temave të diplomave, ashtu edhe në orientimin dhe ndihmesën në lidhje me provimin e formimit. <i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i> <i>Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarisë mesimore.</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	IAL-ja ofron laborator informatike të cilin GVB-ja pati rastin ta vizitonte gjatë vizitës në Institucion. Ky laborator mund të përdorej edhe nga studentët të cilët ishin duke kryer temat e diplomave. Studentët asistohen nga udhëheqësit e tyre të diplomave në rastet kur duhej të hartoheshin pyetësorë apo të kryheshin analiza për temat e tyre të diplomave. <i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Për vlerësimin e provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të punimit të diplomës përdoret një skedë në pikë për vlerësim. Këto pikë konvertohen në notë dhe pasi nota është vendosur në procesverbal, i bëhet me dije studentit të interesuar brenda 72 orëve. Kjo procedurë është e parashikuar në Rregulloren e programit dhe të Departamentit (evidence 3.8) dhe në atë të Sekretarisë mësimore (evidence 3.12). <i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i> <i>Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarisë mesimore.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e	Në përfundim të studimeve, studentët e Masterit "Qeverisje dhe Administrim Publik" pajisjen me diplomën (Evidenca E1) dhe suplementin e diplomës (Evidencë E2). Suplementi është në shqip dhe anglisht. Me kërkesë të tij, studentit mund ti vihet në dispozicion kopje e plotë e programit të studimit, pra syllabus-et e lëndës në përputhje me vitin akademik ku këto lëndë janë zhvilluar sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore (Evidenca 3.12).

plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<i>Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarise mesimore.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore (Evidenca 3.12). <i>E.1. Diploma Master Profesional ne Qeverisje dhe Administrim.</i> <i>E.2. Supplement.</i> <i>Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarise mesimore.</i>			
Konkluzione	Çdo studenti që kërkon të realizojë një temë diplome, i vendoset në dispozicion një udhëheqës/e diplome i/e cili/a e orienton me temën dhe literaturën, një Manual mbi hartimin e temave të diplomave, laborator për të punuar temën e diplomës, procedura për diplomimin dhe për tërheqjen e diplomës e të suplementit të diplomës sa herë që ai e kërkon.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Plani mësimor i programit Master Profesional “Qeverisje dhe Adminsitrim Publik” përmban lëndën e Praktikës profesionale e cila vlen 6 kredite si një prej lëndëve të kategorisë D. Studentëve iu vendoset në dispozicion lista e institucioneve më të cilët AU ka marrëveshje paraprake për zhvillimin e praktikës profesionale ose ata vetë propozojnë një institucion ku mund të kryejnë këtë praktikë. Praktika laboratorike realizohet brenda institucionit, në laboratorin e informatikës. Ky laborator përmban rreth 30 kompiuter fiks dhe iu shërben studentëve për lëndën e Informatikës si edhe për të realizuar temat e tyre të diplomave.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton	Institucioni e garanton realizimin e praktikave profesionale në mënyrën më të mirë të mundshme, në format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore (aty ku është e mundur) me qëllim përfitimin më

realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	të mirë të përfitimit të njohurive praktike për studentët e programit në fjalë. AU ka nënshkruar marrëveshje me insitucione të ndryshme, IAL brenda dhe jashtë vendit, organizata ndërkombëtare dhe organizata qendrore e lokale të listuara në Raportin vjetor e semestral të Departamentit (evidence 1.9 dhe 1.10), por jo me sektorin privat. Këto marrëveshje vlejné edhe për realizimin e praktikave profesionale për studentët. <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i>			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në lidhje me programin Master Profesional “Qeverisje dhe Adiministrim Publik”, praktika profesionale merr një rëndësi veçantë duke pasur parasysh se sa të rëndësishme janë aplikimet në praktikë të njohurive të marra në këtë program. Për realizimin e praktikave profesionale, Departamenti përcakton një koordinator i cili koordinon punën me insitucionet pritëse. Koordinatorët e insitucioneve pritëse e pajisin studentin me një material përshkrues të detajuar në lidhje me praktikën e kryer dhe me vlerësimin nga ana e insitucionit në lidhje me performancën e studentit. Ky vlerësim konvertohet në notë nga koordinatori/komisioni i përzgjedhur në departament sipas modelit të formularit në evidencën E.2. <i>E.2. Praktika e ndjekjes së studentëve gjatë praktikës.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton realizimin e praktikave laboratorike e praktikave profesionale në mënyrën më të mirë të mundshme, në format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më të mirë të përfitimit të njohurive praktike për studentët e këtij programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion, evidentohet se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit në Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” i përshtatet kërkesave të këtij programi studimi. Në këtë program studimi janë angazhuar lektorë dhe ekspertë me tituj dhe grada shkencore, apo Msc., sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në Rregulloren e Albanian University, Tiranë, janë parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik 2023-2024, përbëhet: për vitin akademik 2023-2024: 70.05% pedagogë efektivë (PAE) / 29.5% pedagogë me kontratë (PAK); për vitin akademik 2022-2023: 69,59 % PAE / 30.41% PAK; për vitin akademik 2021-2022: 71.97% PAE / 28.03% PAK; për vitin akademik 2020-2021: 75,97% PAE / 24.03% PAK. Konkretisht, për vitin akademik 2023-2024 gjithsej janë 10 pedagogë, nga të cilët 5 janë pedagogë efektiv (PAE) ku: 1 ka titullin “Profesor i Asocuar”, dhe 4 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 5 kanë gradën Dr.



	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr				
	Prof.As.Dr	2	1	1	
	Dr	4	3	4	5
	MSc		2		
	Total	6	6	5	5
<i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditeluar.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i>					
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mesimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mesimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të dhënat që ka paraqitur Departamenti për planifikimin e ngarkesës për çdo vit akademik dhe për realizimin e ngarkesës mesimore tregojnë respektimin e kornizës ligjore në fuqi. Mbulimi i ngarkesës mesimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, paraqitet si në vijim: Në vitin akademik 23-24: 70.05% PAE / 29.5% PAK; Në vitin akademik 22-23: 69,59 % PAE / 30.41% PAK; Në vitin akademik 21-22: 71.97% PAE / 28.03% PAK; Në vitin akademik 20-21: 75,97% PAE / 24.03% PAK; <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2023-2024 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i>				
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime	Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion, evidentohet se Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka qëndrueshmëri me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata pa afat dhe është i punësuar pranë IAL, kurse për PAK përcakton normën ditore jo më shumë se 4 orë. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, neni 64 për rekrutimin për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik zbatohet rregullorja e AU. <i>Evidenca 1.1.a Statuti AU</i>				



shoqërore dhe shëndetësore.	<i>Evidenca 4.2.b Kontrata PAK</i> <i>Evidenca 4.2.a Kontrata PAE</i> <i>Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësior dhe administrativ. Në Statutin e AU, Rregulloren e Përgjithshme të AU dhe Rregulloret e tjera përcaktohen të gjitha procedurat për rekrutimin të stafit akademik për realizimin e programit të studimit. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi është bërë sipas nevojave të Departamentit, i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike për vendet e punës. Komisioni i vlerësimit pasi shqyrton kandidaturat kalon për propozim tek Dekani. <i>Evidenca 4.3 Shembull i procedures se rekrutimit</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar</i> <i>Evidenca 1.1.a Statuti AU</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Albannian University siguron punësimin e personelit ndihmës akademik referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar</i> <i>Evidenca 4.3 Shembull i procedures se rekrutimit</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2023-2024 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit	Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit dhe ruan përshkrimet e punës, si dhe ruhen dhe azhurnohen në arkivën e Departamentit. GVJ gjatë vizitës kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejti se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. <i>Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore.</i>

akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Të dhënat e paraqitura në RVB dhe dokumentacionin e përcjellë për këtë program studimi tregojnë se Albanian University siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit master Profesional “Qeversije dhe Administrim Publik”. Kapacitetet e AU dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë informacione të përshtatshme në funksion të punimit të temës së diplomës. Nga vizita dhe takimet me studentët u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i të Shkencave Juridike dhe Politike mbështet studentët për realizimin e temave bashkëkohore dhe të dobishme nëpërmjet burimeve që ky personel ka në dispozicion. <i>E.2. Praktika e ndjekjes së studentëve gjatë praktikës.</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të	Departamenti i Shkenace Juridike dhe Politiko-Administrative garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore e përgjithshme dhe specifike e profesorëve, lektorëve, dhe asistent lektorëve të angazhuar në këtë program studimi është në përputhje të plotë me kërkesat e këtij programi sipas natyrës dhe moduleve që ai ka.

tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkenace Juridike dhe Politico-Administrative garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Për realizimin e programit të studimit Master Profesional, Fakulteti i Shkencave Shqopërore, ka mjediset mësimore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për numrin e studentëve për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse, për të zhvilluar mësimin në të njëjtin orar. Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Albanian University ka në funksion për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në godinën qendrore në Bulevardin Zogu I, Tiranë. GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambjent të përshtatshëm dhe hapësira studimi të mjaftueshme. Gjithashtu disponon auditorë për leksione/seminare të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse në godina të të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre. <i>Evidenca 4.4 Planimetritë e godines.</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qendore (Bulevardi Zogu I).</i>

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Mjediset mësimore, auditorët, janë modeste me tabela apo dërrasa dhe ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si videoprojektor dhe PC), si dhe Internet, i disponueshëm për të gjithë. Klasat dhe auditorët janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies sic është sistemi TEAMS sistemi që mundëson përditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor. <i>Evidenca 4.4 Planimetritë e godines.</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovizive, interneti apo edhe dërrasat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit. Për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit janë në dispozicion zyra dhe pajisje kompjuterike të cilat krijojnë kushte normale për realizimin e detyrave për programin e studimit. <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale	Natyra e këtij programi studimi nuk kërkon laboratorë të teknologjisë së avancuar për realizimin e objektivave të tij. GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi laboratorin i infomatikës, i cili ishte i pajisur me programet profesionale. Laboratori është në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore.

sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	Gjatë vizitës në ambjentet e godinës, u theksua se gjatë zhvillimit të orës mësimore, një punjonës i IT gjenden në dispozicion për ndihmë teknike. <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i> Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politike-Administrative ka mjedise mësimore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Gjithashtu, GVJ arsyeton se natyra e këtij programi studimi nuk kërkon mjedise të posaçme për zhvillimin dhe realizimin e tij. <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politike-Administrative ka mjedise mësimore të</i>

	<i>përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës së GVJ në bibliotekë u konstatua se studentët kishin mundësi të merrnin literaturë shtesë në formë elektronike dhe hardcopy. Anëtarësimi në EBSCO (open access) dhe të tjerë garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin Master Profesional. Evidentohet se literatura është kryesisht në anglisht gjë e cila konsiderohet e papërshtatshme për studentët e programit Master Profesional. Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por miratimi i blerjes nuk është realizuar akoma. <i>Evidenca 3.13 Biblioteka online.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga RVB dhe takimet në Departament evidentohet fakti që Departamenti diskuton dhe miraton programet mësimore të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit lidhur me përditësimin e literaturës dhe ndjek botimet e reja nga të gjitha burimet që disponon, sidomos ato që lidhen me programin e studimit. Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por nuk ka diçka konkrete. <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qendore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit	Për të siguruar akses të plotë për studentët, në nivel Fakulteti është një ambient bibliotekë, biblioteka e vendosur te godina kryesore, me salla leximi, kompjutera (2) që u mundëson përdoruesve mësimin e programeve të ndryshme, trajnim mbi përdorimin e katalogut online të bibliotekës dhe aktiviteteve të tjera. Studentët e programit të

në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën elektronike. Salla është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00 - 16:00. <i>E.3. Rregullore e Biblotekes.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<i>Biblioteka e Fakultetit është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentët në përgjithësi por nuk evidentohet përshtatja e këtyre teksteve me programin specifik në MP “Qeverisje dhe Administrim Publik”.</i> Anëtarësimi në EBSCO garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin e studimit, Mastër Profesional. <i>E.3. Rregullore e Biblotekes.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi se AU ka anëtarësim të plotë në EBSCO me kontratë të rinovueshme një vjeçare. AU është abonuar në libraritë elektronike si EBSCO, biblioteka digjitale që përmbajnë revista akademike që mund të aksesohen lirisht nga studentët dhe stafi akademik. AU është gjithashtu pjesë e sistemit ERIC (https://eric.ed.gov/?q=cambridge). Si anëtare e Pitagora RASH lexuesit përfitojnë akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. <i>E.4.1 Marreveshje AU& RASH 2.</i> <i>E.4.2 Marreveshja AU&AC per EBSCO.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka në godinën kryesore është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitale, fillimisht aksesohet në linkun: https://ulibrary.rash.al/ dhe Faqja kryesore e shërbimit përmban krahas një videoje informuese dhe hapat kryesore që duhet të ndiqen. <i>Megjithatë, GVJ rekomandon shtimin e kompjuterave për studentët.</i>

	<i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i> <i>E.4.1 Marreveshje AU& RASH 2.</i> <i>E.4.2 Marreveshja AU&AC per EBSCO.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Salla është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00 - 16:00, të shtunën nga ora 08:00-12:00. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të rishikonin literaturë. <i>E.3. Rregullore e Biblotekes.</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Çdo vit, sipas kërkesave të stafit akademik përgatitet lista e blerjeve për të pasuruar fondin e Bibliotekës. Kërkesat evidentohen në Departament të cilët në fillim të vitit akademik diskutojnë programet e lëndëve, ndryshimet, përmirësimet dhe përcaktojnë kërkesën për literaturën. Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese. Gjithashtu gjenden raporte analitike mbi efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online. <i>E.3. Rregullore e Biblotekes.</i> <i>E.5. Raporte analitike për literaturën shtesë në bibliotekë.</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Konkluzione	<i>AU ka krijuar kushtet për të mbështetur programin e studimit me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e tij. Biblioteka ka</i>

	<i>mjediset e përshtatshme, por evidentohet se literatura është e pamjaftueshme dhe jobashkëkohore gjë e cila konsiderohet e papërshtatshme për studentët e programit.</i> <i>GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekës me literaturë bashkëkohore në MP "Qeverisje dhe Administrim Publik".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Albanian University përmban informacion personal të studentit dhe adresat e tyre elektronike. Studentët gjithashtu, informohen nga faqja zyrtare e AU, www.albanianuniversity.edu.al, rrjetet sociale, në ambjentet brenda godinës. AU ka në website zonën e studentit e cila informon studentët me të gjitha njoftimet, si edhe përmban informacion në lidhje me: manifestin e studentit, shkëmbime dhe praktika, orari, lidhshipi studentor, zyra e komunikimit Alumnit dhe karrierës, bursa dhe tarifa. Përmes sistemit të integruar "Pitagora" prashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit. <i>Evidenca 3.7 Manual i përdorimit të Pitagorës.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të	Burimet njerëzore dhe Departamenti administrojnë dokumentacionin përkatës për partnerët dhe për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Sistemi i UA-së për ruajtjen e informacionit të personelit bazohet në arkivimin e dokumentacionit në formën hardcopy dhe elektronike dhe kjo ka rezultuar efektive. Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore ruan CV-të, ngarkesat dhe dokumenta të tjera të nevojshme që lidhen me veprimtarinë e personelit. Sistemi i bazuar në letër i menaxhimit të dokumentacionit të nevojshëm që përdoret në AU mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët sipas programeve të studimit. Për realizimin e

angazhuar në realizimin e programit.	programit në MP në “Qeverisje dhe Administrim Publik” sistemi i brendshëm i menaxhimit është efikas. <i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2023-2024 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2022-2023 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2021-2022 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>E.8 Ngarkesa mesimore v.a 2019-2020 MP Qeverisje dhe Administrim publik.</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qendore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Shkëmbimi i informacionit midis stafit dhe studentëve bëhet përmes e - maileve të stafit që vihen në dispozicion të studentëve nga fillimi i vitit akademik. Përmes sistemit të integruar “Pitagora” parashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit. <i>Evidenca 3.7 Manual i përdorimit të Pitagorës.</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Monitorimi i aktivitetit akademik e administrativ bëhet nga njësia bazë – Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative që raporton te zv/ Dekani për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar</i> <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter.</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna	Faqja zyrtare e Albanian University www.albanianuniversity.edu.al paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentë të publikuara në 3 (tri) gjuhë, shqip, italisht dhe anglisht. Gjatë vizitës GVJ konstatoi që departamenti nuk ka një politikë të standardizuar apo manual për publikimin, por kryesisht të gjitha aktivitetet publikohen në faqen web të institucionit.

në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Monitorimi i aktivitetit akademik e administrativ për mbarëvajtjen e procesit mësimor bëhet nga njësia bazë dhe ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik dhe realizimin e programit mësimor. AU disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.			
Konkluzione	<i>AU disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit, si dhe monitorimi i aktivitetit akademik dhe administrativ për mbarëvajtjen e procesit mësimor kryhet nga njësia bazë dhe ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik dhe realizimin e programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxheti financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas cikleve dhe programeve të studimit. Planifikimi i financimit realizohet në mënyrë paraprake për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. <i>Mungon një raport financiar i kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetje financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve. Raport i paraqitur në dokumentacion nuk është i mjaftueshëm pasi në të paraqitet opinion i një eksperti dhe nuk është është dokument institucional.</i>


Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban të gjithë elementët financiarë në bazë programi. Plani i financimit të programit të studimit përmban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orë mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative etj., si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe çdo zë tjetër të nevojshëm. <i>Raport i paraqitur në dokumentacion nuk është i mjaftueshëm pasi në të paraqitet opinion i një eksperti dhe nuk është është dokument institucional që pasqyron planin e financimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për detyrë realizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me planet e miratuara, AU kryen auditim të veprimtarisë nga njësitë e auditimit të brendshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brendshëm çdo vit. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të AU. <i>E.6. Raport për veprimtarinë financiare ose raport për auditimin UFO Opinion Eksperti 2023.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe përmban elementët financiarë për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit. Institucioni raporton në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit, për rishikimin dhe për rialokimin e buxhetit, sipas ligjit mbi buxhetin. Institucioni harton Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar AU raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit

	paraardhës. <i>Institucioni nuk disponon raportet financiare për çdo vit akademik.</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Albanian University është një universitet jopublik dhe si i tillë, duhet të garantojë qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, dhe në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. <i>Nuk gjenden evidenca për sa i përket këtij kriteri.</i>			
Konkluzione	<i>AU garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve, por GVJ nuk konstaton raporte apo dokumenta për planin financiar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për verësimin e këtij kriteri, GVJ u bazua në Statutin e vjetër të Albanian University dhe atë të ri të miratuar në 2023, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore; Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” dhe vëren se në Albanian University procesi që nga hyrja deri në daljen e studentëve në të gjithë ciklin e studimit, mbështetet në politika dhe procedura të cilat janë në respektim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit. <i>Evidenca 1.1.a Statuti AU.</i> <i>Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023 i ri.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek AU nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Respektohen detyrimet ligjore mbi regjistrimin, dhe ngrihet një komision <i>ad hoc</i>, i cili pas shqyrtimit të listës së aplikantëve shpall dhe listën e kandidatëve fitues për programin e studimit. Duke u bazuar në Statutin e ri të AU dhe Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore; Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” vihet re se barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje dhe në dalje për të gjithë kandidatët janë vlera të AU si edhe të Fakultetit të Shkencave Shoqërore si një ndër njësitë e tij. Ato garantohen nëpërmjet politikave dhe procedurave që nga seleksionimi, rekrutimi, trajnimi dhe formimi i kandidatëve për studentë, e studentëve të programit të studimit në të gjithë ciklin e studimit. <i>Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023 i ri.</i>



	<i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konfirmon sipas vendimit të Senatit për Kriteret e Pranimiit të Studentëve për studentë për ciklin e studimeve. Kriteret e veçanta që duhen përmbushur nga ana e kandidatëve hartohen dhe bëhen publike si nga ana e AU, Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politike-Administrative në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës informon mbi kriteret e pranimiit dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin. <i>Evidenca 5.6 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimiit për programin e studimit.pdf</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimiit përgjatë kursit të studimit, të transferimiit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimiit të dijeve dhe të diplomimiit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në ambientet e AU konfirmon që kriteret, procedurat e pranimiit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe ka edhe një Vendim senati për kuotat. Edhe procedurat për përparimiin e studentëve, transferimiit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimiit të dijeve dhe diplomimiit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit. Aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me programin e studimit në AU dhe në Fakultetin e Shkencave Shoqërore si një ndër Njësitë e tij, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimiit dhe mjeteve të komunikimiit për kandidatët për student, studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë të gjithë ciklit akademik. <i>Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023 i ri.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 5.5 Vendim për miratimin e kuotave të pranimiit për programin e studimit.</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në ambientet e AU, në godinën kryesore, konfirmoi organizimin e ditëve të informimit për maurantët e shkollave të mesme, kryesisht të rajonit dhe konform një plani. Gjatë javës orientuese, maurantët ftohen në kampus dhe marrin informacion të detajuar për fakultetin dhe për programe specifike të studimit. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimi dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maurantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Në mbështetje të Programit, njoftime nga faqja zyrtare https://albanianuniversity.edu.al/kriteret-e-pranimi/, kandidatët për studentë, të gjithë të interesuarit dhe publiku i gjerë udhëzohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për pranimin në programin përkatës të studimit si nga ana e AU, Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative. <i>Evidenca 5.10 Axxenda e javës orientuese.</i> <i>Evidenca 5.1 Info days per maurantet.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative çdo vit akademik përcakton, harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi veçanta që aplikojnë për program studimi, transferim studimesh, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara për vitin akademik pasardhës. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili merr vendimin përkatës dhe publikohen në faqen zyrtare të AU: https://albanianuniversity.edu.al/kriteret-e-pranimi/. Përsa i përket kuotave, ato i përcillen Bordit të Administrimit për miratim. Pas përfundimit të procedurës nga IAL-ja, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS me afatet e përcaktuara. <i>Evidenca 2.4. Rregullore e Rregjistrimit dhe Trasferimeve.</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, sipas Vendimit të Senatit për Kriteret e Pranimi të Studentëve, përcakton, harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për përzgjedhjen e kandidatëve me shtetësi të huaj për vitin akademik pasardhës. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili mer vendim.

	<i>Evidenca 5.6 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit.</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Kriteret dhe informacioni për përfitimet publikohen nga në faqen zyrtare (https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/ dhe iu komunikohen nga strukturat e AU të interesuarve edhe me kanale të tjera komunikimi dhe me komunikim të drejtpërdrejtë. AU ka të miratuar Rregulloren e përditësuar për trajtimin me bursë të studentëve në nevojë, të cilëve iu mundësohet trajtim i diferencuar. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditësuar.pdf</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>			
Konkluzione	<i>Albanian University ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit për çdo student. GJV konstatoi se studentët ishin të informuar për hapat e procedurave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit	Bazuar në Rregulloren e Re të Albanian University, Rregulloren e Vjetër të saj, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Qeversije dhe Administim Publik”, kalimi nga një vit akademik në tjetrin dhe progresi akademik i studentëve në Albanian University mundësohet nëpërmjet ofrimit të një informacioni të plotë nga ana e Departamentit

akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	të Shkencave Juridike dhe Politike-Administrative. GVJ konfirmoi se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës. <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në Rregulloren e re të AU dhe atë të vjetër, Rregulloren e Fakultetit dhe të Departamentit, si dhe Rregullore e programit të studimit Master Profesional, kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme janë të përcaktuara nga AU dhe të kuptueshme e të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe për të gjithë të interesuarit. <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter.pdf</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituar.pdf</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Duke u bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga AU, informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të aftësive dhe dijeve u vihet në dispozicion studentëve ana e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, si dhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve nga ana e lektorëve të lëndëve respektive që në orën e parë mësimore të semestrit. GVJ në takimin me studentët konfirmoi që studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter.pdf</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituar.pdf</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 5.1 Info days per maurantet.</i> <i>Evidenca 5.7 Udhëzues Orientues për Maurantët.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me	Duke u bazuar në Rregulloren e re të AU dhe atë të vjetër, Rregulloren e Fakultetit dhe të Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politike-Administrative si dhe Rregullore e programit të studimit Master

kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Profesional, të gjitha etapat që lidhen me kriteret dhe procedurat e diplomimit të programit të studimit janë të përcaktuara, të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët duke vënë në dispozicion strukturat përkatëse përgjegjëse dhe kanale e mjete të ndryshme komunikimi. <i>Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter.pdf</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituar.pdf</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative angazhohet në fillim të çdo viti për tërheqjen e kandidatëve potencialë për student duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura ku i shpalosen informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qenë të hapur ndaj feedback, diskutimeve apo sugjerimeve të mundshme. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative në panaiet promovuese të programit të studimit u lejon të kontaktojnë personalisht me maturantët e interesuar duke iu sqaruar avantazhet e regjistrimit në atë program studimi. <i>Evidenca 5.10 Axxhenda e javës orientuese.</i> <i>Të dhëna nga faqja zyrtare https://albanianuniversity.edu.al/sq/</i>			
Konkluzione	<i>Albanian University ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi procesin e zhvillimit të programit të studimit. GJV konstatoi se studentët ishin të informuar për çdo hap të procedurave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative në fillim të çdo viti akademik, organizon një takim informues dhe orientues me studentët ku prezantohen të gjitha elementet e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e institucionit etj. Ndërsa në fillim të vitit akademik të studimit informohen hollësisht mbi detyrimet akademike dhe periudhën e provimeve. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët. <i>Evidenca 5.4 Panairi Eork & Study.pdf</i> <i>Evidenca 5.11 Manuali i studentit.</i> <i>Evidenca 5.10 Axxhenda e javës orientuese.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion GVJ-së iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative nëpërmjet Javës së Orientimit dhe Manualit të Studentit. Studentët kanë akses të plotë dhe transparent mbi dokumentacionin/udhëzuesit e lëndëve/moduleve, përmbajtjen e tyre si dhe aktivitetet formuese të ndërlidhura me to. <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 5.11 Manuali i studentit.</i> <i>Evidenca 5.10 Axxhenda e javës orientuese.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	Zyra e Karrieres dhe Alumnit si pjesë e institucionit, orienton dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikave mësimore, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mundësive të punësimit. Nga takimi që GVJ pati me studentët, ata kishin informacione mbi mundësitë e punësimit, ku një pjesë e tyre ishin tashmë të punësuar. GVJ rekomandoi që të kishin kontakte me institucionet dhe studentët që ende

orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<i>nuk kishin gjetur punë, dhe të suportoheshin në punësimin e tyre, psh duke i orientuar drejt Programit të Praktikave Kombëtare.</i> <i>Evidenca 5.2 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe Zyrën e karrierës.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Albanian University publikon të dhënat në faqen zyrtare ëeb https://albanianuniversity.edu.al/. Gjithashtu, në faqen e internetit studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Gjatë takimeve dhe seancave orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konfirmon se informacioni që ju vihej në dispozicion ishte i plotë e shterues. <i>Evidenca 6.8.c Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor</i> <i>ne AU.</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Për programin e studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”, studentit i ofrohet informacion i përditësuar nga faqja zyrtare https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-shkencave-politiko-administrative/, si dhe përdoren edhe platforma të tjera bashkëkohore për të shpërndarë informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të detajuar lidhur me programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme e të përditësuar edhe në distancë. <i>Evidenca 5.2 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat formuese të secilës lëndë, si dhe kishin informacion të plotë e të hollësishëm për programin e studimit. Gjithashtu, AU vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Të dhënat në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar e diplomuar përfshihen tek analiza vjetore e institucionit si edhe statistikat përfshihen tek vlerësimi i brendshëm i cilësisë. GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kuotat e miratuara. Sipas drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjishme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni. <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th><th>Studentë gjithsej</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td><td>21</td></tr> <tr> <td>2023-2024</td><td>12</td></tr> </tbody> </table> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore.</i>	Viti akademik	Studentë gjithsej	2022-2023	21	2023-2024	12
Viti akademik	Studentë gjithsej						
2022-2023	21						
2023-2024	12						
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me	Nga kontaktet me sekretarinë u vu re se Sekretaritë Mësimore, të cilat janë të ndara sipas fakulteteve, organizojnë punën brenda afateve të paracaktuara për të realizuar regjistrimet e studentëve fitues të programeve të ciklit të dytë të studimit. Sekretaria mësimore hedh të dhënat e studentëve të regjistruar në formatin e miratuar, të cilat pasi konfirmohen nga Kryesekretaria i dërgohen institucionit përkatës për matrikullim. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar, etj, duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e AU. Statistikat e përgatitura arkivohen. AU disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit të						

sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	ciklit të dytë sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Këto të dhëna u verifikuan edhe gjatë vizitës në institucion. <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Studentë të regjistruar</th><th>Studente të transferuar</th><th>Studentë gjithsej</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>19</td><td>2</td><td>21</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>11</td><td>1</td><td>12</td></tr></table> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i>	Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej	2022-2023	19	2	21	2023-2024	11	1	12
Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej										
2022-2023	19	2	21										
2023-2024	11	1	12										
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në Statutin e AU, të dhënat për studentët janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat ruhen konform akteve rregullatore të Universitetit. Të dhënat statistikore të studentëve përgatiten dhe ruhen elektronikisht si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare, kryesekretaret në bashkëpunim me sekretaret mësimore kryejnë pasqyrimin e notave në bazën elektronike të të dhënave konform manualit për funksionimin e sekretarisë. <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i>												
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen	Albanian University ka hartuar manualin për funksionimin e sekretarisë mësimore ku shpjegon qartë jo vetëm saktësinë për ruajtjen e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, por edhe mënyrën e kryerjes në mënyrë periodike të kontrolleve për vlerësimin e të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin, përfshirë sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime												

dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi. Sekretariteti mësimor hartojnë raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. <i>Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarise mesimore.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Rregulloren e vetë departamentit, si edhe rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”, për çdo vit akademik harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve të cilat evidentohen në analiza dhe raportin vjetor të Departamentit. Analiza mësimore vjetore në nivel departamenti i përcillet Fakultetit me qëllim në përfshirjen në analizën vjetore të njësisë kryesore. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se AU ka mbledhur, administruar, përditësuar dhe ruajtur të dhënat në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna në lidhje me punësimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.


Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Kjo është një praktikë e mirë që promovon demokracinë dhe transparencën në proceset vendimmarrëse të institucionit. Rregullorja e re e Albanian University, përcakton përfaqësimin e studentëve në organet e AU, marrjen pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së Universitetit, ku këshillat e studentëve kanë të drejtë të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e Albanian University dhe njërive kryesore si edhe të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të institucionit. Kjo promovon ndjenjën e përgjegjësisë dhe ndjenjën e pronësisë së përbashkët ndër studentët, si dhe rrit transparencën dhe llogaridhënien në proceset vendimmarrëse të institucionit. Aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përcaktojnë procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e tyre në organet vendimmarrëse. Këto akte gjithashtu përcaktojnë mënyrat e komunikimit dhe bashkëpunimit midis përfaqësuesve të studentëve dhe organet vendimmarrëse të institucionit. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituar.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që AU është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi se përfshirja e studentëve mundësohej nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë për vlerësimin e procesit akademik, i cili është një proces që kryhet në mënyrë të pavarur nga secili pedagog në fund të semestrit. Studenti ka të drejtë të japë vlerësimin e vet në mënyrë të pavarur dhe pa praninë e pedagogut të lëndës në auditor në momentin e vlerësimit. Në përfundim të procesit të vlerësimit Njësia e Sigurimit të Cilësisë bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr rezultatet e përfutura nga vlerësimi që diskutohet në Analizën dhe Raportin vjetor të DAP dhe programit të studimit. <i>Evidenca 5.3 Rregullore e zyres se koordinimit dhe mbështetjes ndaj studenteve.</i>

	<i>Evidenca 6.11 Pyetësori online për stafin akademik dhe administrative.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Rregullorja e AU, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Rregullorja e Departamentit si edhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional parashikojnë përfshirjen e studentëve në struktura të rëndësishme të vendimmarrjes me qëllim dhënien e kontributit të tyre në rritjen e cilësisë së vazhdueshme të programeve të studimit. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. GVJ konstatoi se programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi. <i>Nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to.</i> <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditësuar.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ konstatoi se studentët informoheshin mbi studimet universitare dhe provimet, si dhe udhëzimi mbi provimet, çka mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton përcaktimit e procedurës që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditësuar.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët.</i>
Konkluzione	<i>Albanian University përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të</i>

	<i>mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të institucionit. Por në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to. GVJ gjithashtu konstatoi se nuk ka një evidence që ky program të jetë rishikuar në 3-4 vitet e fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Albanian University ka krijuar strukturën e vet, e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, vë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritë, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni). Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qendore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për	Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, por ka në dispozicion edhe një sistem menaxhimi i cili është në dispozicion të çdo studenti. Në javën e parë të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit.

çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Gjatë takimit me studentët, GVJ konfirmoi asistimin e tyre përgjatë procesit mësimor me të gjithë çështjet që lidhen me programin e studimit. <i>Vizita në institucion, takimi me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga vizita në institucion, GVJ u informua se zyra e Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i kësaj zyre të ngritur konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për aktivizimin e potencialeve të tyre, mundësi të ndryshme studimi deri në asistimin dhe përditësimin e CV-së ë tyre. Gjithashtu në këtë kuadër kjo zyrë, organizon aktivitete për studentët, si Open Days që informon studentët për mundësi, si dhe trajnime apo kurse kualifikimi. <i>Evidenca 5.2 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe studentët.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Albanian University ka ngritur dhe vënë në zbatim Zyrën e Karrierës dhe Alumnit në bazë të Rregullores. Kjo zyrë ofron jo vetëm vendosjen e kontakteve me Alumnit të AU me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash, por edhe ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme. <i>GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi pas përfundimeve të studimeve disa shkëpusin kontakt me AU.</i> <i>Evidenca 5.2 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i>
Konkluzione	<i>AU ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e</i>

	<i>problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. GVJ sugjeron promovimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në të gjithë universitetin dhe mbështetje të studenteve që nuk arrijnë të sistemohen me punë pas përfundimit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se Albanian University ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit, të cilat kanë objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxëniet si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme në mbështetje të Rregullores së NJBSC. <i>Evidenca 6.7 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.</i> <i>Evidenca 6.13 Rregullore NJSBC.</i> <i>Evidenca 6.6 a Vendimi per ngritjen e grupeve te sigurimit cilesise per njesine baze.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë	Për të vlerësuar dhe monitoruar aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, struktura përgjegjëse

mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	zhvillon mekanizma të ndryshëm. Këto mekanizma përfshijnë vlerësimin periodik të punës së tyre, si dhe monitorimin e performancës së tyre gjatë kohës. Një mënyrë e zakonshme për të vlerësuar aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik është përmes vlerësimit të mësimdhënies së tyre nga studentët. Kjo bëhet përmes sondazheve të plotësuar nga studentët që organizohet nga zyrat përkatëse, ku ata japin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe aftësitë e pedagogëve. Këto vlerësime janë anonime për të siguruar transparencën dhe sinqeritetin e tyre. <i>Nga dokumentacioni i paraqitur mungojnë pyetësorët nga studentët përgjatë viteve akademike. GVJ konstaton vetëm një vlerësim për mësimdhënien online 2019-2020 (Evidenca 3.2.a Rezultatet e pyetesoreve të studenteve).</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të politikave të institucionit në lidhje me mësimdhënien, organizon një anketim të përvitshëm për të matur vlerësimin e studentëve për performancën e lektorëve. Këto masa kanë për qëllim të sigurojnë përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit dhe të trajtimit të ankimimeve, duke i dhënë atyre mundësinë të japin kontributin e tyre dhe të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit. <i>Nga dokumentacioni i paraqitur mungojnë pyetësorët nga studentët përgjatë viteve akademike. GVJ konstaton vetëm një vlerësim për mësimdhënien online 2019-2020 (Evidenca 3.2.a Rezultatet e pyetesoreve të studenteve).</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ gjatë takimit me pedagogët e Departamentit konstaton se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, kryejnë pyetësorë për çdo semestër akademik, të cilat i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar. <i>Evidenca 6.3 Model Raporti Semestral Pedagog.</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit	Gjatë takimit me pedagogët e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, GVJ konstatoi se krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve AU vlerëson edhe performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon dhe përmirëson ato duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës,

personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	opinionet e marra nga studentët dhe alumni, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënit. <i>Evidenca 6.6.b Grupet e Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet e realizuara me Drejtuesin e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, pedagogët, studentët, konstaton se AU ka të përcaktuar një politikë në nivel institucional dhe në nivel të fakulteteve për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se AU, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, ka organizuar dhe ka miratuar mënyrën e funksionimit të Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, e cila ndër përgjegjësitë e tjera ka dhe menaxhimin e procesit të matjes së performancës, nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve institucionale. Gjithashtu parashikimet ligjore mandatojnë Departamentin si njësi përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse. <i>Evidenca 6.7 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025.</i> <i>Evidenca 6.8.c Rregullore për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor në AU.</i>

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se AU ka miratuar Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025 për realizimin e objektivave dhe politikave në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë të Institucionit. Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e programit dhe stafi akademik konfirmojnë se rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve, përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrit ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % të programit. <i>Evidenca 6.7 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.</i> <i>Evidenca 6.8.c Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU.</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ konstaton se AU përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Ky program studimi, i është nënshtruar akreditimit për herë të parë në 2019, i cili u akreditua për 5 vite akademike, me vendim nr 22 (https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-shoqerore-2/). <i>Vizita në institucion, takimi me Dekanin dhe drejtuesit e programit.</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.	GVJ, pas të dhënave të marra nga RVB, diskutimet me pedagogët dhe studentët, konstaton se është shumë e rëndësishme që institucioni të përdorë tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Këto tregues janë të nevojshëm për të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë e institucionit në mënyrë objektive. Ata ndihmojnë në vlerësimin e performancës së institucionit dhe në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Nga analiza e raportit të vlerësimit të brendshëm institucional



Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	evidentohet se rezultatet e pyetësorëve me studentët janë një instrument që përdoren në funksion të përmirësimit të mësimdhënies. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe iu paraqiten të gjithë strukturave përkatëse duke nisur nga departamentet deri në Senatin Akademik. Kjo krijon një mjedis të stimulueshëm për studentët dhe kontribuon në përmirësimin e performancës së institucionit në përgjithësi. <i>Evidenca 3.2.a Rezultatet e pyetësoreve të studenteve.</i> <i>Evidenca 6.11 Pyetësori online për stafin akademik dhe administrative.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se AU ka hartuar dhe ka zbatuar politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë, dhe keto politika janë zbatuar në nivelin e programit të studimit Master Profesional në "Qeversije dhe Administrim Publik". GVJ udhëzon në vazhdimin e krijimit të praktikave efikase të garantimit të cilësisë së programit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e	Bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore, në varësi të llojit të institucionit. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukture të tij, sipas standardeve të cilësisë.

arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare. GVJ konstaton se Fakultetit të Shkencave Shoqërore bashkëpunon me Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin për mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, rezulton se vlerësimet që bëhen nga analiza vjetore dhe nga vlerësimet e brendshme të Departamentit dhe të Fakultetit, ku përfshihet dhe ky program studimi, analizojnë rezultatet pikërisht duke i krahasuar me atë çfarë ishte planifikuar. Raportet analizuese dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësime të mëtejshme të cilësisë. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në ambientet e AU konstatoi që instrumenti i përdorur është i mjaftueshëm për të siguruar një vlerësim sa më holistik dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundësohet përdorimi periodikisht i tyre. <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 6.10 Raport Vjetor Insitucional v.a 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës,	Gjatë takimeve në institucion, GVJ u informua në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore. Këto metoda të drejtpërdrejta përfshijnë: vlerësim të cilësisë së mësimdhënies, ku bën pjesë dhe ky program studimi; vlerësim të didaktikës, kurrikulës, leksioneve,

kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	syllabuseve, literaturave të përdorura; të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve; procesi i Tutorial/Mentorimit. Këto analizohen dhe miratohen në departament në fillimin e vitit akademik. <i>Vizita në institucion, ambjentet e AU, godina qëndore (Bulevardi Zogu I).</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se përveç metodave të drejtëpërdrejta të kontrollit për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, janë përdorur edhe metoda dhe instrumenta të tërthortë vlerësimi (sondazhe, intervista), kryesisht të fokusuar tek studentët, duke mundësuar kështu një vlerësim të plotë të realizimit të objektivave të programit dhe duke mos mundësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. GVJ sugjeron që e njëjta procedurë (intervista gjysëm të strukturuar, fokus grupe apo dhe sondazhe), të ndiqet në vijueshmëri nga departamenti edhe për ata ish-studentë, bashkëpunëtorë, staf administrativ apo studentëve të këtij programi, si një mënyrë shumë efektive e vlerësimit të përgatitjes akademike që aktualisht ofrohet nga programi, por dhe vlerësimit të aftësive dhe kompetencave që ky program garanton dhe përputhshmërisë së tyre me treguesit real të avancimit akademik apo karrierës profesionale. <i>Evidenca 6.11 Pyetësori online për stafin akademik dhe administrative.</i>
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se AU monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve. GVJ sugjeron që e njëjta procedure të ndiqet në vazhdimësi nga departamenti edhe për ata ish-studentë, bashkëpunëtorë, staf administrativ apo studentëve të këtij</i>

	<i>programi, si një mënyrë shumë efektive e vlerësimit të përgatitjes akademike që aktualisht ofrohet nga programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar është e rëndësishme për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e programit. Kjo përfshirje mund të realizohet nëpërmjet politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë. Aktorët e brendshëm përfshijnë stafin akademik, studentët dhe personelin administrativ të institucionit. GJVJ konstaton se ata kanë rol aktiv në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe procedurave të cilësisë, ku marrin pjesë në diskutime dhe japin kontributet e tyre për përmirësimin e programit të studimit. Aktorët e jashtëm të përfshirë sipas bisedës me pedagogët dhe përgjegjësen e departamentit janë përfaqësues të organizatave profesionale dhe studentët Alumni, të diplomuarit. Përfshirja e tyre është zhvilluar duke i ftuar në panaiet e punës, përmes konsultimeve dhe takimeve. Përfshirja e studentëve shihet edhe në pjesëmarrjen e tyre tek GVB që ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. <i>Evidenca 6.6.b Grupet e Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Evidenca 6.4 Vendimi për ngritjen e zyrës së sigurimit të cilësisë.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Përmes përfshirjes së aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar, institucioni ka përfituar nga perspektivat e ndryshme dhe kontributet e tyre për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit. Kjo gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e një kulture të cilësisë dhe në rritjen e përgjegjësisë së përbashkët në institucion. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike</i>

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<i>dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Për të vlerësuar dhe siguruar cilësinë e programit të studimit, është e rëndësishme të kemi njësinë bazë dhe kryesore që është përgjegjëse për programin e studimit, e cila përfshin anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentë të programit të studimit Master Profesional në “ Qeverisje dhe Administrim publik” GVJ konstaton se kjo përfshirje e të gjithë palëve të interesuara realizohet. Kjo është e rëndësishme për të siguruar një proces të drejtë dhe të përshtatshëm të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se kjo përfshirje është e drejtë, transparente dhe e bazuar në kriteret e përcaktuara paraprakisht. Aktorët e brendshëm, si profesorët, stafi administrativ dhe studentët, kanë mundësi të kontribuojnë në proceset e vlerësimit, duke dhënë mendimet dhe vlerësimet e tyre në mënyrë të lirë dhe të ndershme. Kjo ndihmon në rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së të gjithë palëve të përfshira në procesin e vlerësimit. Gjithashtu, është e rëndësishme të sigurohet se këto procese janë të hapura për të gjithë dhe nuk favorizojnë asnjë grup ose individ në mënyrë të padrejtë. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është shumë i rëndësishëm për të siguruar integritetin akademik dhe për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazi ndaj personelit dhe studentëve. <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politico-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të	Nga takimet me pedagogët dhe drejtuesit e njësive u shprehën se pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore është përfshirja e

cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Këta individë kanë lidhje me programin e studimit dhe kanë ekspertizë të veçantë në fushën e lidhur me cilësinë e programit, çka u konstatua edhe gjatë takimit të GJV me pedagogët. Përvoja dhe mendimet e tyre të vyera janë të dobishme për të vlerësuar cilësinë e programit dhe për të identifikuar mënyra për përmirësimin e saj. Kjo përfshirje e ekspertëve të jashtëm sjell një perspektivë të re dhe ndihmon në rritjen e cilësisë së programit. <i>Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditesuar.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Profesional.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e departamenteve dhe Fakultetit të Shkencave Shoqërore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	Nga takimet e drejtëpërdrejta me studentët, GVJ konstatoi se për grupet e reja të studentëve realizohet java informuese, ku studentët informohen nga lektorët e departamentit në lidhje me funksionimin dhe organizimin e çdo programi studimi. Pranë AU prej vitesh realizohet raportimi vjetor lidhur me realizimin e objektivave të parashtruara. Në të njëjtin format edhe pranë fakulteteve dhe

programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	departamenteve realizohet në mënyrë periodike informim dhe mendimarrje nga strukturat e ndryshme me kolegët lektorë, stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet web-it të AU, komunikimeve me email, takimeve informuese dhe publikimet në rrjetet sociale, studentët informohen periodikisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Gjithashtu në faqen e internetit të institucionit gjenden të publikuara informacione të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e NJSBC https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/ <i>Evidenca 6.13 Rregullore NJSBC.</i> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se AU në mënyrë periodike realizon takime dhe aktivitete me qëllim njohjen me rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit. Këto takime kanë formën e diskutimeve dhe bashkëbisedimeve mbi materialet finale të raporteve të vetëvlerësimit sic edhe është parashikuar në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Gjithashtu, GVJ konstaton se është përgatitur Rregullorja e NJSBC, e cila konsiston në përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Publikimi i informacionit përmes këtij programi ka si qëllim t'i shërbejë transparencës të organizimit dhe funksionimit si dhe të misionit dhe veprimtarisë së AU dhe realizohet përmes publikimit të këtij informacioni në faqen zyrtare të internetit, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. <i>Evidenca 6.13 Rregullore NJSBC.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, si edhe ky program studimi i janë nënshtruar një vlerësimi të mëparshëm të procesit të akreditimit. Vlerësimet dhe analizat e realizuara identifikojnë nevojat për përmirësime të metejshme. Stafi i Fakultetit të Shkencave Shoqërore angazhohen dhe marrin masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të metejshme. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

	<i>Evidenca 6.10 Raport Vjetor Insitucional v.a 2022-2023.</i> <i>Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre. Duke marrë në konsideratë evidencën e dërguar me shkresë nr Prot, 137/1 më 18 mars 2025 nga AU, GVJ e ka rishikuar dhe ka vendosur të pranojë komentin e bërë nga institucioni.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politike-Administrative gjithashtu në përputhje me kërkesat për cilësië afatgjatë organizon veprimtari informuese me studentët e secilit cikël të studimeve. <i>Faqja zyrtare https://albanianuniversity.edu.al/sq/</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente dhe efektive. Konkretisht, kjo është realizuar nëpërmjet publikimit të Rregullores së AU, Rregullores së Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI				X
--	--	--	--	----------

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në
“Qeversije dhe Administrim Publik” ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”**

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Pikat e forta dhe afirmime

1. Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative kanë kapacitetin, burimet dhe përvojën e duhur për ofrimin e Masterit Profesional “Qeverisje dhe Adminsitrim Publik” në burime njerëzore, operative dhe në kapacitete infrastrukturore.
2. Kushtet infrastrukturore në Kampusin e AU mundësojnë zhvillimin e një procesi mësimor bashkëkohor.
3. Personeli akademik i kualifikuar dhe me profil në përputhje me objektivat e programit studimor e bën këtë program mjaft tërheqës për studentin, si dhe angazhimi i tyre në mobilitete me universitete partnere ndërkombëtare dhe projekte rrit cilësinë e mësimdhënies.

Pika të dobta

1. Mungesa e një Koordinatorit të programit në nivel departamenti (*Standardi I.3, Kriteri I*).
2. Mungesa e përditësimit të syllabus-eve me literaturë të viteve të fundit (*Standardi II.3, Kriteri IV*).
3. Mungesë të një plani financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit (*Standardi IV.5, Kriteri 2*).
4. Mungesë të literaturës të përditësuar të viteve të fundit në gjuhën shqipe, të përshtatshme për nevojat e programit të studimit (*Standardi IV.3, Kriteri I*).

Rekomandime

1. Departamenti dhe grupi i punës për rishikimin e kurrikulave të përdorë mundësinë e rishikimi të programit me 20% në mënyrë që ta përshtasë këtë program me inovacionin dhe nevojat e tregut.
2. Rekomandohet një shtrirje e praktikave edhe në administratën e kompanive e bizneseve private, jo vetëm të atyre publike dhe një Koordinator program.
3. Institucioni, të shohë me prioritet shtimin e literaturës në gjuhën shqipe në syllabuset e lëndëve dhe përditësimin e syllabuseve të këtij programi studimi si edhe numrin e titujve specifik të fushës së administrimit publik në bibliotekën e AU me tituj të fundit nga literaturë ndërkombëtare.
4. Universiteti të hartojë një plan financiar të kostove të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetje financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programeve.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Governance and Public Administration" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"

Strengths and affirmations

1. The Albanian University, the Faculty of Social Sciences and Department of Legal and Political-Administrative Sciences possess the capacity, resources and experience to offer this Professional master's degree "Governance and Public Administration" in human resources, operational and infrastructural capacities.
2. There are excellent infrastructural conditions on the AU Campus that enable the development of a contemporary learning process.
3. There is a qualified academic staff with a profile in line with the objectives of the study program, a feature which makes this program very attractive to students. Their engagement in mobility with international partner universities and projects increases the quality of teaching.

Weaknesses

1. There is a lack of a Program Coordinator at the department level (*Standard I.3, Criteria I*).
2. There is a lack of updated syllabuses with literature from recent years (*Standard II.3, Criteria IV*).
3. There is a lack of a funded cost plan of the basic units responsible for the study program (*Standard IV.5, Criteria 2*).
4. There is a lack of updated literature of recent years in the Albanian language, appropriate for the needs of this study program (*Standard IV.3, Criteria I*).

Recommendation

1. The Department and the Working Group for the Curriculum Review should use the opportunity to revise the program by 20% in order to adapt this program to innovation and market needs.
2. It is highly recommended to extend the internships to the administration of private companies and businesses, not only public ones, and to appoint a program coordinator, as well.
3. The institution should prioritize the addition of literature in the Albanian language to the course syllabi and should incentivate the updating of the syllabi of this study program, as well as the number of specific titles in the field of public administration in the AU library with international recent publications.

4. The university should draft a funded plan of the costs of the basic units responsible for the study program and the plan for financial support necessary for the smooth running of the programs.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit



FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

